FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 4	2001	Shkurt

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8732 datë 24.1.2001	Për materialin mbjellës bimor ……	95
Ligj nr.8733 datë 24.1.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"…	100
Ligj nr.8734 datë 1.2.2001	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike……	117
Ligj nr.8736 datë 1.2.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", ndryshuar me ligjin nr.8605, datë 20.4.2000……	123
Vendim i Kuvendit nr.471, datë 12.2.2001	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	124
Vendim i Kuvendit nr.472, datë 12.2.2001	Për kthimin për rishqyrtim të raportit përfundimtar të Komisionit për Caktimin e Kufijve të Zonave Zgjedhore	124

Vendim i KM Nr.592, datë 2.11.2000	Për miratimin e flamurit dhe të Stemës së Policisë së Shtetit……	125
Vendim i Gj.K nr. 3 datë 29.1.2001	Me objekt: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.240, datë 17.7.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.170, datë 26.10.1998 të Kolegjit të Gjykatës së Kasacionit…….	127
Udhëzim nr. 6278 datë 11.12.2000	Për miratimin e Rregullores së Barrëve Siguruese ……..	128

L I G J
Nr.8732, datë 24.1.2001

PËR MATERIALIN MBJELLËS BIMOR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin dhe tregtimin e materialit mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Atestim" është procedura e punës për pajisjen me certifikatë të një varieteti, kultivari, hibridi ose kloni të ri, për regjistrimin e tij në Regjistrin Themeltar dhe në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe të bimëve pyjore dekorative.
2. "Bankë gjenetike" është institucioni në varësi të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve që grumbullon, ruan, ripërtërin, studion, vlerëson dhe administron germoplazmën bimore.
3. "Certifikim" është procedura për pajisjen me certifikatë për treguesit sasiorë dhe cilësorë të materialit mbjellës bimor.
4. "Katalogu Zyrtar i specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe të bimëve pyjore e dekorative" është regjistri në të cilin regjistrohen speciet dhe varietetet, materiali mbjellës i të cilave lejohet të riprodhohet, shumëzohet e të tregtohet në Republikën e Shqipërisë. Në të cilësohen varietetet e listës "A" dhe të listës "B".
5. "Lista A" është regjistri i varieteteve që janë regjistruar në Katalogun e OECD-së (Organizata për Zhvillim e Kooperim Ekonomik).
6. "Lista B" është regjistri i varieteteve të kualifikuara nga Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve dhe regjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve.
7. "Klon" është një grup bimësh që rrjedhin nga shtimi vegjetativ i një bime të vetme.
8. "Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve" është organi që shqyrton dhe kualifikon ose jo varietetet e reja për t'u regjistruar në Regjistrin Themeltar dhe Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve.
9. "Material mbjellës bimor" janë farat, fidanët, copat, kalemat, sythat, tuberat, bulbet, kamzat, llastunjat dhe çdo pjesë tjetër e bimëve që shërben për mbjellje dhe riprodhimin e tyre.
10. "Material mbjellës bimor gjenetik" janë popullatat, linjat, incuktlinjat dhe klonet e bimëve bujqësore.
11. "Material mbjellës bimor i ri (i krijuar)" janë kultivarët, linjat prindërore, hibridet dhe klonet e reja të krijuara rishtazi.
12. "Material mbjellës bimor shumëzimi" është materiali bimor që përdoret për shtimin e tij të mëtejshëm.
13. "Farë" është ovula e pjekur dhe pjellore që përmban embrionin e prodhuar nga bimë që kanë lulëzuar, si dhe pjesë të bimës si tubere, bulba etj., që shërbejnë për të dhënë një ose disa bimë të reja.
14. "Fidan" është një bimë e re e drufrutorëve dhe drurëve pyjorë e dekorativë që ka pjesën

nëntokësore (rrënjët) dhe pjesën mbitokësore (trupin) e ardhur nga mbirja e farave, nga shpërthimi i sythave të vendosur në rrënjë, nga kamza dhe nga rrënjëzimi i pjesëve mbitokësore (copa, kalema, lastunja etj.) e cila shërben për mbjellje.

15. "Fidan i shartuar" është një bimë e formuar nga dy pjesë bimore të bashkuara nëpërmjet shartimit, pjesa nëntokësore e së cilës është prodhuar me një nga mënyrat e përshkruara në pikën 14 dhe pjesa mbitokësore e formuar nga një kalem ose syth i marrë nga një bimë tjetër, e cila ruan cilësitë e bimës nga është marrë.

16. "Riprodhim" është prodhimi i një ose më shumë bimëve ose materialeve mbjellëse bimore nëpërmjet shumëzimit seksual dhe/ose vegjetativ.

17. "Regjistri Themeltar i specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe bimëve pyjore e dekorative" është regjistri ku mbahen të shënuara të gjitha speciet, varietetet, kultivarët e hibridet që janë përdorur, përdoren dhe që futen përsëri në prodhim, sipas rregullave të vendosura.

18. "Shumëzim" është procesi i shtimit të materialeve mbjellëse bimore.

19. "Testim" janë provat krahasuese, që kryhen në dy e më shumë zona, për të vërtetuar aftësitë prodhuese dhe cilësore të një varieteti, kultivari, hibridi ose kloni.

20. "Varietetet" janë një grup bimësh të së njëjtës specie që kanë karakteristika të njëjta.

KREU II
KRIJIMI, RIPRODHIMI DHE SHUMËZIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

Neni 3

Kanë të drejtë të krijojnë material mbjellës të ri bimor për përhapje dhe tregtim, institucionet kërkimore-shkencore e arsimore, shtetërore e private dhe të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Krijuesit e çdo materiali të ri mbjellës bimor i njihet e drejta e autorësisë dhe e pronësisë me vendim të Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve. Vendimet e këtij Komisioni shpallen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

U njihet e drejta e autorësisë dhe e pronësisë të gjithë autorëve ose bashkautorëve që janë shpallur si të tillë, me vendim të Komisionit të Atestimit të kultivarëve dhe hibrideve të rinj dhe që janë regjistruar në Katalogun Zyrtar të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

Për të njohur autorësinë dhe pronësinë për materialet mbjellëse bimore të rinj ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve organizon dhe/ose mbikëqyr kryerjen e provave të testimit, që kryhen vetë ose nga institucione të tjera të vendit, shtetërore ose private, që janë të pajisura me leje nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për kryerjen e kësaj veprimtarie.

b) Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, vetë ose në bashkëpunim me institucionet që kanë kryer provat e testimit, në përfundim të tyre, i bën propozimin me shkrim Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve.

c) Komisioni Shtetëror i Atestimit të Variteteve shqyrton propozimin e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, si dhe raportin përfundimtar të provave të testimit. Pas kualifikimit të materialeve mbjellëse bimore, ky komision i propozon Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit njohjen e autorësisë dhe të pronësisë.

ç) Të drejtat e autorësisë rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 5

Riprodhimi dhe shumëzimi i çdo kategorie të materialit mbjellës bimor lejohet të bëhet nga çdo krijues i materialit të ri mbjellës, nga institucionet kërkimore-shkencore dhe arsimore-shtetërore ose private dhe të gjithë personat e tjerë fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që:

a) të merret leje ose autorizim nga pronari nëse varieteti është me pronësi;

b) të disponohet dokumenti që vërteton origjinën e materialit fillestar, farë ose materiale shumëzimi vegjetativ;

c) materiali mbjellës bimor që riprodhohet dhe shumëzohet, të jetë i regjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve, në listën "A" ose "B", përjashtuar farat e perimeve dhe të luleve;

ç) të sigurohet zbatimi i kushteve të domosdoshme teknike për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor, të përcaktuara me akte nënligjore të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve;

d) të merret leje nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, i cili brenda një afati prej 45 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti përkatës, duhet t'i kthejë përgjigje, në të kundërt leja do të konsiderohet e dhënë automatikisht.

Kriteret e dhënies së lejes për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor përcaktohen me akte të veçanta të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 6

Lejohet riprodhimi dhe shumëzimi i materialit mbjellës bimor, të paregjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve për persona fizikë dhe juridikë të huaj, me drejtim përdorimin jashtë territorit të Shqipërisë, me përjashtim të riprodhimit dhe të shumëzimit të materialeve mbjellëse bimore, të ndaluara me ligj.

KREU III
TREGTIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

Neni 7

Lejohet të tregtojnë material mbjellës bimor, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të pajisur me leje për të ushtruar veprimtari tregtare nga organet përkatëse gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Lejohet të tregtohet material mbjellës bimor kur:

a) i përket specieve bimore dhe varieteteve (kultivarë, hidrid dhe klone) të tyre, që janë regjistruar në listën "A" dhe "B" të Katalogut Zyrtar të specieve dhe varieteteve, përjashtuar farat e perimeve dhe luleve;

b) është i pajisur me deklaratën e konfirmitetit sipas specifikimeve teknike, në përputhje me ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin";

c) disponohen dokumente që vërtetojnë origjinën e materialit mbjellës bimor që tregtohet;

ç) disponohet certifikata e analizave laboratorike e lëshuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Për rastet e materialeve mbjellëse bimore, që importohen dhe futen për herë të parë në tregun shqiptar, përveç kërkesave të mësipërme, të shoqërohen dhe me dokumentacionin e nevojshëm për zonat e përhapjes dhe teknikën e kultivimit.

Në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore për lloje dhe kontigjente të caktuara të materialit mbjellës bimor, me vendim të Këshillit të Ministrave, lejohet tregtimi dhe mbjellja e materialit mbjellës bimor, me tregues cilësorë të paparashikuar në standardet shqiptare.

Neni 9

Kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialet mbjellëse bimore, të prodhuara brenda vendit, për tregtim të brendshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Institucionet shkencore dhe arsimore, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, si dhe subjekte të tjera që merren me krijimin dhe ruajtjen e materialit mbjellës bimor, vetëm me urdhër të titullarit të institucionit kanë të drejtë të shkëmbejnë material mbjellës bimor në sasi të vogla për qëllime shkencore dhe eksperimentale me institucionet shkencore jashtë vendit ose me persona fizikë dhe juridikë të huaj, pa iu nënshtruar procedurave doganore.

Kufijtë e sasive të farave sipas llojeve, që lejohen të shkëmbehen për këtë qëllim, si dhe ato që ndalohen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV
PROCEDURAT E KONTROLLIT DHE TË VLERËSIMIT CILËSOR TË MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

Neni 11

Në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit vepron Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, i njësuar me drejtoritë e dikasterit, i cili përgjigjet për:

a) organizimin dhe kryerjen e provave të testimit të materialeve mbjellëse bimore të reja, të krijuara dhe/ose të importuara, vetë dhe/ose me mbikëqyrës;

b) kryerjen e analizave laboratorike zyrtare për treguesit cilësorë të materialeve mbjellëse bimore. Këto analiza kryhen në Laboratorin e Entit Shtetëror të Farave e Fidanëve dhe laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit. Treguesit cilësorë të materialeve mbjellëse bimore, që analizohen, përcaktohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

c) organizimin e grumbullimit, të ruajtjes, ripërtëritjes, studimit, vlerësimit dhe këmbimit të germoplazmës bimore të vendit nëpërmjet institucionit të bankës gjenetike;

ç) mbajtjen dhe plotësimin e vazhdueshëm të Regjistrit Themeltar dhe të Katalogut Zyrtar të specieve dhe varieteteve. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit shton ose heq varietete në Katalogun Zyrtar të specieve dhe të varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara e të bimëve pyjore e dekorative, mbi bazën e vendimit të Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve;

d) integrimin dhe anëtarësimin e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë që merren me trajtimin e materialit mbjellës bimor, si dhe me organizma homologë të vendeve të tjera;

dh) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe kritereve të vendosura në këtë ligj dhe në aktet nënligjore për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, tregtimin dhe importimin e materialit mbjellës bimor, për të cilin funksionon Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. Të drejtat dhe detyrat e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) certifikimin e materialeve mbjellëse bimore, vetë ose nga agjenci private. Organizimin dhe procedurat e kryerjes së certifikimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me akte të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

Funksionimi, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe akte të tjera që nxjerr Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në zbatim të këtij ligji.

Neni 12

Testimi i materialeve mbjellëse bimore bëhet në mënyrë vullnetare.

Neni 13

Për vlerësimin dhe kualifikimin e materialit mbjellës bimor, funksionon Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve. Përbërja dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni caktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

KREU V
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 14

Sipas këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e dispozitave të parashikuara për:

a) shumëzimin dhe riprodhimin e materialeve mbjellëse bimore në kundërshtim me nenet 5 e 6 të këtij ligji. Përjashtohen nga detyrimet që rrjedhin nga ky nen personat që prodhojnë materiale mbjellëse bimore me porosi të personave fizikë e juridikë vendas dhe të huaj. Në këtë rast përgjegjësitë ligjore bien mbi porositësin;

b) tregtimin e materialeve mbjellëse bimore në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji.

Neni 15
Ndëshkimet

Për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 14 të këtij ligji nga organet e kontrollit të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, jepen këto ndëshkime:

Për shkeljet e parashikuara në pikën 1:

Vihet 50-300 mijë lekë gjobë për shkeljet që parashikohen në shkronjën "d" të nenit 5 të këtij ligji dhe bllokim deri në plotësimin e kërkesave ligjore. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 5 dhe nenit 6 të këtij ligji, merret masë sekuestrimi dhe asgjësimi i materialit të mbjellë dhe të prodhuar ose kalimi për konsum për rastet kur prodhimi është i konsumueshëm.

b) Për shkeljet e parashikuara në pikën 2:

Merret masë sekuestrimi, asgjësimi ose kalim për konsum, kur materiali është i konsumueshëm, përsa parashikohet në shkronjat "a", "b" dhe "ç" të nenit 8 dhe gjobë 20-30 mijë lekë për çdo 100 mijë lekë të vlerës së sasisë të materialit mbjellës bimor dhe bllokim deri në plotësimin e kërkesave ligjore, përsa parashikohet në shkronjat "c" dhe "ç" të nenit 8.

Neni 16

1. Organet që kanë të drejtë të vendosin masa administrative janë:

a) Kryeinspektori i farave e fidanëve, inspektori i këtij inspektorati, si dhe çdo person tjetër i autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, për vendosjen e masës së gjobës dhe të bllokimit.

b) Kryeinspektori i farave e fidanëve për masën e sekuestrimit, të asgjësimit ose kalimit për konsum, kur materiali mbjellës bimor përcaktohet i konsumueshëm; për këtë qëllim ngrihet një komision vlerësues nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

2. Kundër vendimit të dhënë nga inspektori bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit te Kryeinspektori i farave e fidanëve. Kundër vendimit të dhënë nga Kryeinspektori i farave dhe i fidanëve bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit te Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Ngarkohen Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të nenit 8, 9, 10 dhe 11 dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në zbatim të neneve 4, 5, 8, 11 dhe 13.

Neni 18

Ligji nr.7659, datë 12.1.1993 "Për farat dhe fidanët", si dhe çdo dispozitë që bie në

kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2895, datë 9.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8733, datë 24.1.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995
"KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 1 shtohen nenet 1/a, 1/b dhe 1/c me këtë përmbajtje:

"Neni 1/a
Bazat e legjislacionit penal

Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale.

Neni 1/b
Detyrat e legjislacionit penal

Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre.

Neni 1/c
Parimet e Kodit Penal

Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit.

Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet."

Neni 2

Në nenin 7 shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“d) Organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike.”

Neni 3

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i tretë dhe i katërt ndryshohen si vijon:

“Për personat që kryejnë krim gjoba jepet nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë.

Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50 mijë gjer në 5 milionë lekë.”

- Pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita penale parashikon vetëm dënim me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë nga 100 mijë gjer në 5 milionë lekë.”

- Në paragrafin e shtatë fjalët “1 mijë” bëhen “5 mijë”.

Neni 4

Neni 45 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën “b” shtohen fjalët “ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material;”

- Pas shkronjës “gj” të shtohen shkronjat “h” dhe “i” me këtë përmbajtje:

“h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë;

i) kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive.”

Neni 6

Në nenin 57, në paragrafin e tretë, fjalët “1 mijë” bëhen “5 mijë”.

Neni 7

Neni 64 ndryshohet si vijon:

“Lirimi para kohe me kusht

I dënuari me burgim mund të lirohet para kohe me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve."

Neni 8

Neni 74 ndryshohet si vijon:

"Krime kundër njerëzimit

Vrasjet, shfarosjet, kthimi në skllevër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, kundër një grupi të popullsisë civile për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 9

Neni 77 ndryshohet si vijon:

"Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër

Vrasja me dashje, që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet."

Neni 10

Neni 78 ndryshohet si vijon:

"Vrasja me paramendim

Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

Vrasja e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm."

Neni 11

Neni 79 ndryshohet si vijon:

"Vrasja në rrethana të tjera cilësuese

Vrasja me dashje e kryer:

ndaj të miturit;

b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;

c) ndaj deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, policit, ushtarakut, nëpunësit publik, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;

ç) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse;

d) më shumë se një herë;

dh) kundër dy ose më shumë personave;

e) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës;

ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave

dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 12

Pas nenit 83 të shtohet neni 83/a me këtë përmbajtje:

"Kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje

Kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje, që i bëhet një personi a të mituri për t'u ngujuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Neni 13

Pas nenit 88 shtohen nenet 88/a dhe 88/b me këtë përmbajtje:

"Neni 88/a

Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike

Plagosja e rëndë, e kryer në gjendje të tronditjes të fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 88/b

Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme

Plagosja e rëndë, e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, dënohet me burgim gjer në tre vjet."

Neni 14

Në nenin 96, shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:
"Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet."

Neni 15

Neni 100 ndryshohet si vijon:

"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.
Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.
Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet."

Neni 16

Neni 101 ndryshohet si vijon:

"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë
me të mitur të moshës 14-18 vjeç

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën katërmbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.
Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me

burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet."

Neni 17

Në nenin 102 paragrafi i parë dhe i dytë ndryshohen si vijon:

"Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 18

Pas nenit 102 shtohet neni 102/a me këtë përmbajtje:

"Neni 102/a

Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur

Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga dy gjer në shtatë vjet.

Kur marrëdhënia homoseksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 19

Neni 103 ndryshohet si vijon:

"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona
të pazotë për t'u mbrojtur

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke përfituar nga pazotësia fizike ose mendore e personit të dëmtuar ose, nga vendosja në gjendje të pandërgjegjshme, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 20

Neni 104 ndryshohet si vijon:

"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale
me kërcënim me përdorimin e armës

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 21

Neni 105 ndryshohet si vijon:

“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet.”

Neni 22

Neni 106 ndryshohet si vijon:

“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona
në gjini ose nën kujdestari

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.”

Neni 23

Në nenin 107, pas fjalës “seksuale” shtohen fjalët “ose homoseksuale”.

Neni 24

Në nenin 108 fjalët “me persona” zëvendësohen me fjalët “me të mitur”.

Neni 25

Neni 109 ndryshohet si vijon:

“Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t’iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Po kjo vepër e kryer ndaj të miturit nën moshën 14 vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet dhe, kur është shkaktuar vdekja, me burgim të përjetshëm.”

Neni 26

Pas nenit 109 shtohet neni 109/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 109/a

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese

Kur personi i rrëmbyer ose i mbajtur peng lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi ose mbajtja peng, pa e arritur qëllimin e krimit dhe, kur ndaj personit nuk është ushtruar torturë ose dëmtime të tjera të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në pesë vjet.”

Neni 27

Në nenin 110 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Kur kjo vepër shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet."

Neni 28

Pas nenit 110 shtohet neni 110/a me këtë përmbajtje:

"Trafikimi i njerëzve

Trafikimi i njerëzve, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe, kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm."

Neni 29

Në nenin 114/a bëhen këto ndryshime:

- Pika 6 ndryshohet si vijon:

"6. Kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike."

- Në paragrafin e fundit hiqen fjalët "dhe me konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve".

Neni 30

Pas nenit 114/a shtohet neni 114/b me këtë përmbajtje:

"Neni 114/b

Trafikimi i femrave për prostitucion

Trafikimi i femrave për prostitucion, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin e saj, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe, kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm."

Neni 31

Neni 116 shfuqizohet.

Neni 32

Në nenin 119 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit."

Neni 33

Në nenin 120 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 34

Në nenin 124 në paragrafin e parë fjalët "14 vjeç" zëvendësohen me fjalët "16 vjeç".

Neni 35

Pas nenit 128 shtohen nenet 128/a e 128/b me këtë përmbajtje:

"Neni 128/a

Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës

Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës me një tjetër, i kryer nga personeli mjekësor, dënohet me burgim nga tre gjer në tetë vjet.

Neni 128/b

Trafikimi i fëmijëve

Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm."

Neni 36

Në nenin 134 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 37

Në nenin 136 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 38

Në nenin 137 në fillim shtohet një paragraf si vijon:

"Lidhja e paligjshme me rrjetin e energjisë elektrike, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet".

Neni 39

Pas nenit 138 shtohet neni 138/a me këtë përmbajtje:

"Neni 138/a

Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës

"Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i veprave të artit dhe të kulturës, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 40

Neni 140 ndryshohet si vijon:

"Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen pa leje të armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 41

Pas nenit 141 shtohet neni 141/a me këtë përmbajtje:

"Neni 141/a
Trafikimi i mjeteve motorike

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 42

Në nenin 143 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet dhe, kur ka sjellë pasoja të rënda, me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 43

Pas nenit 143 shtohet neni 143/a me këtë përmbajtje:

"Neni 143/a
Skemat mashtruese dhe piramidale

"Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, me qëllim fitimi material, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 44

Në nenin 147, fjalët "tre vjet" zëvendësohen me fjalët "katër vjet".

Neni 45

Në nenin 148, fjalët "një vit" zëvendësohen me fjalët "dy vjet".

Neni 46

Në nenin 149, pas fjalës "gjobë" shtohen fjalët "ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 47

Në nenin 170/a, në paragrafin e parë dhe të dytë, përpara fjalës "dënohet", shtohen fjalët "përbën kundërvajtje penale dhe".

Neni 48

Neni 175 ndryshohet si vijon:

"Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore

Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Neni 49

Neni 178 ndryshohet si vijon:

"Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë

Tregtimi, tjetërsimi ose transportimi i mallrave që dihet që janë kontrabandë, si dhe çdo ndihmë tjetër që u jepet personave që merren me këto veprimtari, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Neni 50

Neni 183 ndryshohet si vijon:

"Falsifikimi i monedhave

Falsifikimi ose vënia në qarkullim e monedhave të falsifikuara dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 51

Neni 184 ndryshohet si vijon:

"Falsifikimi i letrave me vlerë

Falsifikimi ose vënia në qarkullim i çeqeve, kambialeve, kartëkrediteve, çekudhëtarëve ose letrave të tjera me vlera të falsifikuara, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Neni 52

Në nenin 185 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Neni 53

Pas nenit 192 shtohen nenet 192/a dhe 192/b me këtë përmbajtje:

"Neni 192/a

Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve

Asgjësimi me çdo mënyrë i dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, si dhe zhdukja e vjedhja e dokumenteve që janë të një rëndësie të veçantë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Vjedhja e dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, që janë të një rëndësie të veçantë, ose eksportimi i tyre në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 192/b

Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike

Ndërhyrja në çdo formë, në transmetimet dhe programet kompjuterike, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet."

Neni 54

Në nenin 235, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet."

Neni 55

Në nenin 236, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre gjer në shtatë vjet."

Neni 56

Në nenin 239 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë, fjalët "gjashtë muaj" zëvendësohen me fjalët "një vit."
- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet botërisht ose në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 57

Në nenin 240, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Po kjo vepër, kur kryhet botërisht ose në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 58

Neni 248 ndryshohet si vijon:

"Shpërdorimi i detyrës

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror ose me shërbim publik, kur i kanë sjellë pasoja të rënda interesave të ligjshme të shtetasve ose shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet."

Neni 59

Në nenin 262 shtohet paragrafi i fundit:

"Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 60

Në nenin 278 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në paragrafin e parë, fjala "pesë" bëhet "tre".
- Në paragrafin e dytë, hiqen fjalët "blerja ose shitja".
- Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

"Mbajtja e municionit luftarak pa leje të organeve kompetente shtetërore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

- Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur vepra kryhet në sasira të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 61

Pas nenit 278 shtohet neni 278/a

"Neni 278/a

Trafikimi i armëve dhe i municionit

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i armëve dhe municionit luftarak, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Neni 62

Pas nenit 282 shtohet neni 282/a me këtë përmbajtje:

"Neni 282/a

Tratifikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 63

Në nenin 283 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet."

- Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

- "Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 64

Neni 283/a ndryshohet si vijon:

"Trafikimi i narkotikëve

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave

narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 65

Pas nenit 283/a shtohet neni 283/b me këtë përmbajtje:

"Neni 283/b

Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës

Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca narkotike ose psikotrope, i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e këtyre substancave, në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, dënohet nga tre gjer në shtatë vjet."

Neni 66

Në nenin 284 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet."

- Pas paragrafit të parë shtohen një paragraf me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet."

- Në paragrafin e dytë, fjalët "nga pesë gjer në dhjetë vjet" zëvendësohen me fjalët "nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet".

Neni 67

Pas nenit 284/b shtohen nenet 284/c dhe 284/ç me këtë përmbajtje:

"Neni 284/c

Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope

Prodhimi, fabrikimi, nxjerrja, rafinimi, përgatitja pa licencë ose në kapërcim të përmbajtjes së tij i lëndëve narkotike dhe psikotrope, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 284/ç

Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve

Prodhimi, importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi dhe mbajtja, në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, i prekursorëve të treguar me ligj në tabelat përkatëse, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se njëherë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 68

Neni 285 ndryshohet si vijon:
"Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike

Prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdollojshme, e pajisjeve, e materialeve, në rast se dihet që ato përdoren ose do të përdoren për prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike a psikotrope, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Neni 69

Pas nenit 285 shtohen nenet 285/a dhe 285/b me këtë përmbajtje:

"Neni 285/a

Përshtatja e lokalit për përdorim droge

Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 285/b

Hedhja ose braktisja e shiringave

Hedhja ose braktisja e shiringave, në vende publike ose të hapura për publikun, si dhe në mjedise private të përdorimit të përbashkët të shiringave ose instrumenteve të rrezikshëm, të përdorura për marrjen e substancave narkotike ose psikotrope, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit."

Neni 70

Në nenin 286 bëhen këto ndryshime:
- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:
"Nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose dhënia në përdorim ose injektimi i tyre te të tjerët, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet."
- Në paragrafin e dytë, fjalët "nga dhjetë gjer në" zëvendësohen me fjalët "jo më pak se".

Neni 71

Pas nenit 286 shtohet neni 286/a me këtë përmbajtje:

"Neni 286/a
Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë

Prodhimi dhe përdorimi i sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 283 gjer 286/a të këtij Kodi ose për të mundësuar ose lehtësuar konsumimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose për të transmetuar a përhapur njoftime publicitare për stimulimin e përdorimit të tyre, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 72

Pas nenit 287 shtohet neni 287/a me këtë përmbajtje:

"Neni 287/a

Pastrimi i parave të pista

Kryerja e veprimeve financiare ose e veprimeve të tjera ekonomike me qëllim pastrimin e parave, që dihet se rrjedhin nga veprimtari kriminale, si dhe rivënien në qarkullim dhe përdorimin e tyre për veprimtari sipërmarrëse ose ekonomike të çdo lloji, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet dhe, kur ka sjellë pasoja të rënda, me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 73

Pas nenit 288 shtohet neni 288/a me këtë përmbajtje:

"Neni 288/a

Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë

Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

Neni 74

Në nenin 298, pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Kur kryerja e kësaj vepre penale sjell si pasojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të një a më shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se shtatë vjet."

Neni 75

Në nenin 306, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Dëshmia e rreme e bërë përpara gjykatës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Neni 76

Në nenin 312, përpara fjalës "dëshmi" shtohen fjalët "deklarime ose".

Neni 77

Pas nenit 313 shtohet neni 313/a me këtë përmbajtje:

"Neni 313/a

Zhdukja ose humbja e fashikullit

Zhdukja ose humbja me çdo mënyrë e fashikullit të hetimit ose të gjykimit, si dhe heqja prej

tyre e dokumenteve, shkresave ose të dhënave të tjera që ndodhen të bashkuara me to, kur ka sjellë pasoja të rënda në dëm të interesave të shtetasve ose të shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet."

Neni 78

Pas nenit 320 shtohet neni 320/a me këtë përmbajtje:

"Neni 320/a

Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës

Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi penal ose civil të gjykatës, civil, nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Neni 79

Në nenet 73, 74, 78, 79, 109 paragrafi i dytë, 141, 208, 209, 219, 221 paragrafi i dytë, 230 dhe 334 hiqen fjalët "a me vdekje".

Neni 80

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 81

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2899, datë 13.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8734, datë 1.2.2001

PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë garantimin e sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku elektrik.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Futje në treg" kuptohet lëvrimi ose vënia në dispozicion të të tretëve të pajisjeve elektrike të përcaktuara në këtë nen.

2. "IPIE" kuptohet Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.

3. "Kontroll teknik" kuptohet inspektimi i organizuar në periudha të caktuara kohe, dhe kur del e nevojshme edhe jashtë këtyre periudhave, për verifikimin dhe plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë.

4."Pajisje dhe instalime" kuptohen:

a) Pajisje dhe instalime të tensionit të ulët të projektuara për tension alternativ 50 – 1000 volt dhe 75 – 1500 volt për tension të vazhduar.

b) Pajisje dhe rrjete me tension të mesëm dhe tension të lartë mbi 1000 volt.

c) Pajisje elektrike të radiologjisë dhe të aparaturave për qëllime të tjera mjekësore.

ç) Pajisje elektrike për transport mallrash e pasagjerësh, si dhe pajisjet speciale për përdorim në anije, aviacion dhe hekurudha.

5. "Përdorimi i pajisjes elektrike" kuptohet çdo veprim i lidhur me përdorimin e pajisjes elektrike, si vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, përdorimi, transporti, riparimi, modifikimi, mirëmbajtja, duke përfshirë edhe pastrimin.

6. "Trupi inspektues" kuptohet një grup kontrolli i miratuar nga IPIE-ja dhe i autorizuar nga ministri përkatës për kryerjen e detyrave në zbatim të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 3
Kërkesat thelbësore të sigurisë

1. Pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregulloret në fuqi të projektimit, përdorimit, shfrytëzimit dhe vlerësimit të konformitetit.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, nxjerr aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 4
Futja në treg

1. Pajisjet dhe materialet elektrike lejohen të futen në treg dhe të vihen në shfrytëzim vetëm nëse nuk rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale.

2. Para futjes në treg, prodhuesi ose importuesi i pajisjeve dhe i materialeve elektrike duhet t'ia nënshtrojë këto një procedure inspektimi në përputhje me nenin 3 pika 2.

3. Lejohet futja në treg e pajisjeve dhe materialeve të certifikuara nga organizmat e huaj, në rast se për këtë qëllim ekzistojnë marrëveshje dy ose shumëpalëshe.

Neni 5
Mbikëqyrja dhe heqja nga tregu

1. Kur IPIE-ja vëren se një pajisje ose instalim elektrik i përcaktuar sipas nenit 2 dhe i përdorur në përputhje me destinimin e saj, rrezikon sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale, merr masat e nevojshme për të hequr pajisjen ose instalimin nga

tregu dhe nga shfrytëzimi.

2. Masa e marrë u bëhet e njohur menjëherë të interesuarve. Kundër kësaj mase mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

KREU II
PËRDORIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE

Neni 6
Kontrolli teknik

1. Pajisjet dhe instalimet elektrike para vënies në shfrytëzim duhet të kontrollohen në aspektin e sigurisë së jetës të njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga specialisti elektrik i caktuar posaçërisht nga subjekti furnizues me energji elektrike. Rezultatet e kontrollit paraqiten me shkrim dhe ruhen nga të dyja palët.

2. Personi juridik, që përdor pajisje ose instalime elektrike, merr të gjitha masat për të kryer kontrollin teknik periodik të çdo pajisjeje ose instalimi, sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e sigurimit teknik për pajisjet dhe instalimet elektrike të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. IPIE-ja inspekton në çdo kohë pajisjet ose instalimet elektrike për punën e tyre normale, avari ose kur ndodhin aksidente, për të ruajtur kushtet e sigurisë e për të zbuluar dhe mënjanuar të metat e vëna re.

4. Për rezultatet e kontrolleve teknike mbahen aktkontrolle me detyra dhe afate për shmangien e të metave të vëna re.

5. Kontrollet teknike kryhen nga:

a) specialisti elektrik, i caktuar posaçërisht nga punëdhënësi;

b) një inspektor ose nga një grup inspektorësh të IPIE-së;

c) një trup inspektues, palë e tretë e autorizuar nga IPIE-ja.

Neni 7
Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike, të vëna në dispozicion të punëmarrësve të ndërmarrjes ose të institucionit, të jenë të përshtatshme për punën që do të kryhet, duke garantuar sigurinë dhe shëndetin.

2. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike gjatë përdorimit të tyre të mirëmbahen nëpërmjet kryerjes së shërbimeve, të riparimeve dhe të pastrimeve në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat e rregulloreve teknike.

3. Çdo instalim elektrik duhet të ketë projektin përkatës. Çdo montim ose rikonstruksion në instalimet elektrike bëhet me projekt.

Neni 8
Informimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme që punëmarrësi të marrë të dhënat e duhura dhe udhëzimet përkatëse për përdorimin e pajisjeve elektrike.

2. Të dhënat dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, përsa u përket:

kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve elektrike;

situatave anormale të parashikueshme;

c) përdorimit të mjeteve mbrojtëse individuale dhe kolektive për parandalimin e aksidenteve në punë;

ç) dhënes së ndihmës së parë mjekësore në rast aksidenti.

3. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesin.

Neni 9
Formimi i punëmarrësve

Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

b) në rastin e riparimit, të modifikimit ose mirëmbajtjes së pajisjeve ose të instalimeve elektrike, punëmarrësit e interesuar duhet të kualifikohen në mënyrë të posaçme për t'i kryer këto detyra.

2. Punëdhënësi siguron që punëmarrësit të njihen me të dhënat e duhura dhe t'u bëhet instruktimi:

a) kur caktohen në vendin e punës;

b) kur në pajisjen elektrike që përdoret bëhen modifikime;

c) periodikisht, të paktën një herë në vit.

3. Të dhënat dhe instruksionet duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, në përputhje me nenin 8 pika 2.

4. Punëmarrësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për rreziqet që paraqesin për ta pajisjet elektrike që përdorin dhe për çdo ndryshim që ndikon në sigurinë e tyre.

Neni 10
Këqyrja e avarisë

1. Për çdo rast avarie në pajisjet dhe instalimet elektrike ose aksidenti i shkaktuar nga pajisjet dhe instalimet elektrike, punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij duhet të njoftojë menjëherë IPIE-në dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës për këqyrjen e aksidentit ose të avarisë.

2. Ndalohet riparimi ose ndryshimi i vendit të ngjarjes deri në përfundim të këqyrjes, përveç rastit kur rrezikohet jeta e njerëzve, dëmtohet më tej pajisja, ose pengohet në masë prodhimi.

3. Punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij është i detyruar t'i japë IPIE-së çdo të dhënë për kryerjen e këqyrjes.

4. Në rast aksidenti në punë, i shkaktuar nga pajisjet ose instalimet elektrike, inspektori i IPIE-së bashkëpunon me inspektorin e punës për këqyrjen e aksidentit.

KREU III
INSPEKTORATI I PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE (IPIE)

Neni 11
Mbikëqyrja për zbatimin e ligjit

IPIE-ja mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 12
Statusi i IPIE-së

1. Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike është organizëm teknik dhe kontrollues në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. IPIE-ja është person juridik dhe ka një zë të veçantë në Buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë Publike e të Privatizimit. Organizimi, funksionimi dhe struktura e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. IPIE-ja drejtohet nga Kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike e Privatizimit.

Neni 13
Detyrat e IPIE-së

Krahas detyrave në zbatim të kërkesave të neneve të mësipërme, IPIE-ja kryen edhe këto detyra:

a) Harton rregulloren e funksionimit të saj e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, si dhe kontrollon plotësimin e kërkesave të sigurisë së pajisjeve ose të instalimeve elektrike për rilicencimin e veprimtarisë nga autoriteti përgjegjës.

b) Miraton projektet elektrike të objekteve me fuqi të instaluar mbi 20 kilovatë.

c) Kryen inspektime në subjektet private ose publike, që kryejnë veprimtari me pajisjet dhe instalimet elektrike. Mban shënime për inspektimet e kryera, si dhe për avaritë e aksidentet e ndodhura me natyrë elektrike.

ç) Jep miratimin për autorizimin nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të trupave inspektues palë e tretë, për kryerjen e detyrave të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 14
Të drejtat e IPIE-së

1. Për zbatimin e detyrave të caktuara nga ky ligj, IPIE-ja ka të drejtë të hyjë në çdo kohë në prani të punëdhënësit, të administratorit ose të përfaqësuesit të tyre, në objekte ku ndodhen pajisje dhe instalime elektrike.

2. IPIE-ja, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve, ka për detyrë:

a) të lerë aktkontroll me detyra dhe afate për mënjanimin e shkeljeve;

b) të lërë aktndalesë për një periudhë të caktuar kohe ose përgjithmonë, kur gjykon se një pajisje ose instalim elektrik nuk garanton sigurinë;

c) të propozojë për largimin nga puna të punonjësve që punojnë në pajisjet dhe instalimet elektrike, që nuk kanë njohuritë e duhura të rregullave të sigurimit teknik;

ç) të marrë masa administrative me gjobë, sipas nenit 17, dhe, për raste shkeljesh të rënda të rregulloreve të sigurimit teknik me pasoja për jetën e njerëzve, të kërkojë ndjekje penale.

3. IPIE-ja, me kërkesën e përdoruesit e kur justifikohet me masat e marra, shtyn afatin e kryerjes së kontrollit teknik periodik për një kohëzgjatje të caktuar.

4. IPIE-ja kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit:

kur inspektori cenohet gjatë kryerjes së detyrës;

b) kur nuk zbatohet urdhri i ndalesës së një pajisjeje ose instalimi elektrik që përbën rrezik të hapur për jetën e njerëzve;

c) kur nuk lejohet të hyjë në objektin ku mund të ndodhet pajisja ose instalimi elektrik.

5. IPIE-ja bashkëpunon me persona ose shërbime përkatëse publike ose private për kryerjen e ekspertizës, për krijimin e grupeve të punës dhe për kryerjen e kontrolleve të veçanta.

Neni 15
Burimet financiare të IPIE-së

Burimet financiare të IPIE-së janë:

Buxheti i Shtetit;

b) të ardhura me destinacion, që realizohen nga shërbimet për të tretët.

2. IPIE-ja realizon të ardhura nga shërbimet që kryhen në subjektet private dhe publike nga:

a) veprimtaria kryesore sipas neneve 4, 6, 9 të këtij ligji. Këto të ardhura derdhen në Buxhetin e Shtetit;

b) të ardhurat me destinacion nga shërbimet për të tretët derdhen në llogarinë e IPIE-së dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera, ndërsa 10 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

3. Tarifat për këto të ardhura caktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 16
Pavarësia dhe paanshmëria

1. IPIE-ja, Kryeinspektori dhe inspektorët nuk mund të jenë projektues, prodhues, furnizues, montues ose përdorues të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike dhe as përfaqësues të tyre.

Ata nuk mund të ndërhyjnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në projektimin, prodhimin, tregtimin ose mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve dhe instalimeve, as të përfaqësojnë palë që marrin pjesë në këto veprimtari. Kjo nuk përjashton mundësinë e shkëmbimit të të dhënave teknike ndërmjet prodhuesit të pajisjeve elektrike ose të materialeve elektrike dhe IPIE-së.

2. Inspektorët e IPIE-së duhet ta kryejnë vlerësimin me përgjegjësi të plotë profesionale e teknike dhe të jenë të lirë nga çfarëdolloj presioni ose nxitje, sidomos të natyrës financiare, që mund të ndikojë në gjykimin e tyre ose në rezultatin e kontrollit, në mënyrë të veçantë nëse vijnë nga persona ose grup personash të interesuar për rezultatet e verifikimeve.

3. Inspektorët e IPIE-së duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi lidhur me:

formimin teknik dhe profesional;

b) njohjen e kërkesave për kontrollet që kryejnë dhe një përvojë të mjaftueshme në këto kontrolle;

c) aftësi për të hartuar certifikimet, procesverbalet dhe relacionet, ku konkretizohen kontrollet e bëra.

4. Inspektorët në ushtrimin e detyrës së tyre duhet të jenë të paanshëm.

5. Personeli i IPIE-së ruan sekretin profesional për gjithçka që vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë, sipas këtij ligji.

6. Nëse personeli i IPIE-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë sipas këtij ligji, nxjerr ndonjë sekret të prodhimit ose të tregtimit të proceseve të punës, ndaj tij merren masa disiplinore, të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të IPIE-së.

Neni 17
Kundërvajtjet administrative

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkeljet e dispozitave të neneve 3, 4, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale;

b) tejkalimi i afatit të lënë nga IPIE-ja për mënjanimin e shkeljeve;

c) shkelja e rregullave të mbikëqyrjes teknike të përcaktuara në rregulloret e IPIE-së nga punëdhënësi ose punonjësi i caktuar për mbikëqyrjen teknike.

2. Masa e gjobës është nga 2 mijë deri në 500 mijë lekë.

3. Mënyra e llogaritjes së gjobës bëhet sipas metodikës së dhënë në rregulloret e nxjerra nga Ministria e Ekonomisë Publike e Privatizimit.

4. Inspektori i IPIE-së që konstaton shkeljen harton në vend procesverbalin, i cili shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave të IPIE-së që kryesohet nga Kryeinspektori.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet në prani të kundërvajtësit. Kur vërtetohet se ai ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje, shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë.

6. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave të IPIE-së mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 18
Ekzekutimi i gjobës

1. Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë.

Pas kalimit të këtij afati për çdo ditë vonesë paguhet një kamatë prej 2 për qind deri në 1 muaj. Kur pas këtij afati gjoba nuk paguhet, zbatohet ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 19
Shfuqizime

Dekreti nr.3503, datë 7.5.1962 "Mbi Inspektoratin Shtetëror të Sigurimit Teknik për Instalimet dhe Pajisjet Elektrike" dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2897, datë 9.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8736, datë 1.2.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8093, DATË 21.3.1996 "PËR REZERVAT UJORE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8605, DATË 20.4.2000

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me këtë përmbajtje:

"Për shkeljet e parashikuara në nenin 24, kundërvajtësit dënohen si më poshtë:

a) për pikën 3 (shkelja e afatit), me gjobë deri në 100 mijë lekë dhe, në rast përsëritje, deri në 1 milionë lekë;

b) për pikën 4, me gjobë deri në 500 mijë lekë dhe në rast përsëritjeje me pezullim veprimtarie për një afat 2-mujor ose heqjen e lejes."

Neni 2

Në nenin 1 të ligjit nr.8605, datë 20.4.2000 bëhet ky ndryshim:
Shkronja "a" e paragrafit të dytë të nenit 61 ndryshohet si vijon:
"a) gjobë deri në 1 milionë e 500 mijë lekë;"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2898, datë 9.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.471, datë 12.2.2001

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 17, 22 dhe 25 pika 6, të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores të Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Zgjidhet zoti Tomor Malaj në detyrën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të zotit Shahin Bistri, i cili ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.472, datë 12.2.2001

PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË ZONAVE ZGJEDHORE

Në mbështetje të neneve 71 dhe 72 pika 1 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe të Ligjeve

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Kthen për rishqyrtim Raportin Përfundimtar të Komisionit për Caktimin e Kufijve të Zonave Zgjedhore me rekomandimet bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raporti i Rishikuar për Caktimin e Kufijve të Zonave Zgjedhore duhet të paraqitet në Kuvend brenda datës 24.2.2001.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.592, datë 2.11.2000

PËR MIRATIMIN E FLAMURIT DHE TË STEMËS SË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e flamurit të Policisë së Shtetit, sipas modelit dhe me elementët përbërës, të treguar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e stemës së Policisë së Shtetit, sipas modelit dhe me elementët përbërës, të treguar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në vendimin nr.332, datë 2.6.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e uniformës dhe stemës së policisë", dispozitat që bëjnë fjalë për stemën e policisë shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR.1
MODELI I FLAMURIT TË POLICISË SË SHTETIT



ELEMENTËT PËRBËRËS TË FLAMURIT TË POLICISË SË SHTETIT

Pjesa valvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një copë mëndafshi, me përmasa 140x100 cm, gjysma e së cilës është me ngjyrë të kuqe dhe gjysma tjetër me ngjyrë blu, e ndarë në pjesë të barabartë. Në mes të flamurit është vendosur shqiponja, sipas modelit të flamurit kombëtar. Shqiponja në gjysmën e pjesës blu është me ngjyrë të kuqe dhe ajo e pjesës së kuqe në ngjyrë të zezë. Flamuri konturohet nga një shirit me ngjyrë të artë.

Pjesa jovalvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë dhe me ngjyrë të argjendë.

LIDHJA NR.2
MODELI I STEMËS SË POLICISË SË SHTETIT



ELEMENTËT PËRBËRËS TË STEMËS SË POLICISË SË SHTETIT

Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7x9.5 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë, ndërsa pjesa e poshtme në formë ovale. Fusha është në ngjyrë të kuqe dhe në mes është vendosur figura e një shqiponje ne vështrim nga e majta. Shqiponja është në ngjyrë të zezë, me sqep dhe gjuhë në ngjyrë të verdhë. Në pjesën e poshtme të shqiponjës janë vendosur horizontalisht dy shirita në ngjyrë blu. Stema konturohet nga një shirit në ngjyrë të artë. Poshtë, jashtë stemës, gjatë përdorimit të saj shënohen me germa kapitale fjalët:

"POLICIA E SHTETIT-SHQIPËRI"

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga, Anëtar i ""
Kristofor Peçi, Anëtar i ""
Kujtim Puto, Anëtar i ""
Sokol Sadushi, Anëtar i ""
Alfred Karamuço, Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.12.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.88/1 Akti, që i përket:

KËRKUES: LULËZIM LAMA, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.240, datë 17.7.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.170, datë 26.10.1998 të Kolegjit të Gjykatës së Kasacionit

Në kërkesë si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, përfaqësuesi i kërkuesit ka parashtruar si shkak:

- Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili ka deklaruar fajtor e dënuar në mungesë me dy vjet heqje lirie, ka bërë ankim Prokurori i Rrethit të Krujës dhe Gjykata e apelit Tiranë e ka shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuesit dhe të avokatit, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 426 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, duke u zhvilluar një proces i parregullt, atij i është mohuar e drejta e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen,

V Ë R E N :

Gjykata e Rrethit të Krujës, ka gjykuar në mungesë kërkuesin Lulëzim Lama, i akuzuar për shkelje të rregullave të qarkullimit automobilistik me pasojë vdekje dhe në bazë të nenit 290 të Kodit Penal, me vendimin nr.37, datë 26.5.1998 e ka dënuar me 2 (dy) vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokurori i Rrethit të Krujës dhe Gjykata e Apelit në Tiranë, me vendimin nr.240, datë 17.7.1998, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e dënuar kërkuesin me 8 (tetë) vjet burgim. Gjykata e Kasacionit (Kolegji Penal) nuk ka pranuar për shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuesi, duke arsyetuar në vendimin nr.170, datë 26.10.1998, se rekursi nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin, se vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegji Penal të Gjykatës së Kasacionit, janë rezultat i një procesi të parregullt në kuptimin kushtetues duke u cënuar e drejta themelore e kërkuesit për mbrojtje.

Kërkuesi Lulëzim Lama, është gjykuar në mungesë në gjykatën e faktit, duke iu caktuar kryesisht një mbrojtës. Nga Gjykata e Apelit, ku është shqyrtuar apeli i prokurorit që kërkonte ndryshimin e vendimit, duke caktuar një dënim më të rëndë, edhe pse kërkuesi ishte përsëri në mungesë, nuk është marrë asnjë masë për të realizuar mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës. Gjykata e Apelit, në radhë të parë, nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me njoftimet para fillimit të gjykimit. Nga ana tjetër, ajo s'ka marrë asnjë masë për t'i caktuar një mbrojtës kërkuesit që vazhdonte të gjykohej në mungesë. Kjo do të garantonte një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes të të drejtave të tij dhe do të siguronte një proces të rregullt ligjor. Aq më tepër që në rastin në fjalë, çështja në Gjykatën e Apelit, shqyrtohej mbi ankimin e prokurorit, i cili pretendonte, se kërkuesit i ishte dhënë një dënim i butë. Veç kësaj, kjo Gjykatë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e ka bërë nëpërmjet shqyrtimit në themel, duke i rivlerësuar provat e administruara nga gjykata dhe duke arritur në konkluzione krejt të kundërta, pa u zbatuar parimi i kontradiktoritetit.

Megjithëse kjo shkelje është rilevuar, krahas problemeve të tjera, në rekursin paraqitur Gjykatës së Kasacionit, Kolegji Penal, padrejtësisht nuk e kalon çështjen për shqyrtim dhe me vendimin nr.170, datë 26.10.1998 arsyeton, se nuk ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, Kolegji anashkalon faktin, se pikërisht mungesa e mbrojtjes, në rastin konkret, është shkelje e parimeve esenciale të procesit penal, gjë që e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 42 pika 2 e 131 shkronja "f" të Kushtetutës dhe 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.240, datë 17.7.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.170, datë 26.10.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit.

Dërgimin e çështjes Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

Tiranë, më 29.1.2001
Nr.88/1 i Regj. Themeltar
Nr. 3 i Vendimit

U D H Ë Z I M
Nr. 6278, datë 11.12.2000

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BARRËVE SIGURUESE

Në bazë të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 të ligjit Nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese" Ministri i Financave

U D H Ë Z ON :

Neni 1
Përkufizimet

Termat e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtim kuptim të dhënë nga ligji "Për barrët siguruese".

Automjet
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 54 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë Nr.8378, datë 22.7.1998

Barrëmarrës
është barrëmarrësi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit "Për barrët siguruese" dhe kur është e përshtatshme i referohet gjithashtu edhe një agjencie shtetërore.

Barrëdhënës
është barrëdhënësi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit "Për barrët siguruese" dhe kur është e përshtatshme i referohet gjithashtu edhe një debitori sipas një pretendimi shtetëror.

Barrë siguruese
është barra siguruese sipas përkufizimit të nenit 1 të ligjit "Për barrët siguruese".

Ciklomotor
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 52 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Emri i personit
është emri i pasuar nga atësia dhe mbiemri në rastin e personit fizik;
është emri i rregjistruar sipas vendimit të gjykatës në rastin e personit juridik

Kryeregjistruesi
është Kryeregjistruesi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit "Për barrët siguruese".

Makinë bujqësore
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 57 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Makinë teknologjike
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 58 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998

Mallra me numër serie
janë mallrat që renditen si vijon: automjete, ciklomotorë, makina bujqësore, makina teknologjike, mjete fluturimi, mjete lundrimi, motomjete, motorë mjeti fluturimi, rimorkio, trolejbuse.

Mjet fluturimi
është çdo lloj makinerie që siguron mbështetje në atmosferë nga reagimet e ajrit. Këtu përfshihet trupi i makinerisë, por nuk përfshihet motori i makinerisë.

Mjet lundrimi

është një mjet i ndërtuar për të transportuar persona ose sende, nëpërmjet ujit dhe që vihet në lëvizje kryesisht nga çdo lloj tjetër force, përveç forcës së muskujve dhe që i kalon gjashtë metra gjatësi.

Motomjet

është mjeti sipas përkufizimit të nenit 53 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Motor mjeti fluturimi

është motori i një mjeti fluturimi.

Numri i identifikimit

është numri i identifikimit që Kryeregjistruesi i jep barrëmarrësit ose personit regjistrues.

Numri i serisë

është numri i identifikimit, i shënuar përgjithmonë apo i ngjitur në mallrat me numër serie nga prodhuesi. Ky numër përfshin vetën karaktere alfa-numerike, por jo shenja pikësimi, vija ndarëse apo shenja të tjera. Kur malli është mjet fluturimi, numri i serisë është numri që vendoset nga prodhuesi mbi veshjen e jashtme të tij. Kur malli është motor i një mjeti fluturimi, numri i serisë është numri që vendoset nga prodhuesi mbi motor.

Regjistri

është Regjistri i Barrëve Siguruese siç përkufizohet në nenin 1 të ligjit "Për barrët siguruese".

Rimorkio

është mjeti sipas përkufizimit të nenit 56 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Trolejbus

është mjeti sipas përkufizimit të nenit 55 të Kodit të Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Neni 2

Regjistrimi

Formularët e Regjistrit të Barrëve Siguruese janë si më poshtë:

Njoftimi A – Regjistrimi i Barrës Siguruese. Ky njoftim ka shtojca.

Njoftimi B – Ndryshimi i Regjistrimit. Ky njoftim ka shtojca.

Njoftimi C – Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore.

Njoftimi D – Kërkesa për Informacion

Njoftimet dhe shtojcat duhet të plotësohen sipas Udhëzuesit të Kryeregjistruesit siç parashikohet në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

Personi regjistrues është përgjegjës për të siguruar se njoftimi është plotësuar saktësisht e plotësisht dhe në përputhje me ligjin "Për barrët siguruese", me Rregulloren e Barrëve Siguruese dhe me Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Neni 3

Udhëzuesi i Kryeregjistruesit

Kryeregjistruesi mund të japë udhëzimet e tij për plotësimin e njoftimeve dhe herë pas here mund të ndryshojë, plotësojë dhe shfuqizojë udhëzimet kur është e përshtatshme.

Neni 4

Kohëzgjatja e regjistrimit

Regjistrimi i barrës siguruese është i vlefshëm për afatin prej 1 deri në 25 vjet ose pafundësisht siç shënohet në njoftimin e regjistrimit, me përjashtim të rasteve kur barra fshihet përpara mbarimit të këtij afati.

Regjistrimi i një pretendimi shtetëror është i vlefshëm deri në çastin që fshihet.

Regjistrimi bëhet i vlefshëm nga çasti i futjes së të dhënave në sistemin e Regjistrit dhe është i gjetshëm siç parashikohet në nenin 28 pika "dh" të ligjit "Për barrët siguruese".

Riregjistrimi i një regjistrimi është i pavlefshëm nëse përpara momentit të riregjistrimit kanë ndodhur dy ngjarjet e mëposhtme:

a) të paktën njëra nga kërkesat e përmendura në nenin 8 pika a-ç të ligjit "Për barrët siguruese", që ka lidhje me një barrë siguruese konkurruese, është përmbushur pas fshirjes apo përfundimit të regjistrimit; dhe

b) të paktën njëra nga kërkesat e përmendura në nenin 8 pikat a-ç të ligjit "Për barrët siguruese" që ka lidhje me një barrë siguruese konkurruese është përmbushur para fshirjes apo përfundimit të regjistrimit.

Kryeregjistruesi do të drejtojë veprimtarinë e Regjistrit në mënyrë të tillë që të sigurojë që secili regjistrim dhe ndryshim regjistrimi të ketë një numër regjistrimi unik.

Neni 5
Ndryshimet

Njoftimi B do të përdoret për të ndryshuar një regjistrim.

Ndryshimet janë si vijon:

a) zgjatje e një regjistrimi,

b) fshirje e një regjistrimi,

c) riregjistrimi i një regjistrimi që ka përfunduar apo është fshirë,

ç) nënrenditje e një regjistrimi,

d) shtim i një barrëmarrësi,

dh) fshirje e një barrëmarrësi,

e) ndryshim i informacionit /transferimi i të drejtës së barrëmarrësit,

ë) shtim i një barrëdhënësi,

f) fshirje e një barrëdhënësi,

g) ndryshim i informacionit/transferim i të drejtës së barrëdhënësit,

gj) shtim kolaterali,

h) fshirja kolaterali,

i) ndryshim i informacionit mbi kolateralin/zëvendësimi i kolateralit,

j) ndryshime të tjera/vendim gjykate,

k) korrigjim i Regjistrit.

Neni 6
Nënshkrimi

Njoftimi duhet të nënshkruhet nga barrëmarrësi ose nga një person tjetër i autorizuar për ta bërë këtë në emër të tij.

Një simbol elektronik që është i aprovuar nga Kryeregjistruesi ose numri i identifikimit që caktohet nga Kryeregjistruesi është i mjaftueshëm.

Deri sa Kryeregjistruesi të bindet se të gjithë barrëmarrësit e shënuar në regjistrimin që do të ndryshohet kanë dhënë autorizimet e tyre, Kryeregjistruesi nuk do të bëjë ndryshimet e mëposhtme ndaj atij regjistrimi:

a. fshirje regjistrimi,

b) fshirje barrëdhënësi,

c) ndryshim informacioni/transferim i të drejtës së barrëdhënësit,

ç) fshirje kolaterali,

d) ndryshim i informacionit mbi kolateralin/zëvendësim i kolateralit.

Deri sa Kryregjistruesi të bindet se barrëmarrësi i shënuar në regjistrimin që do të ndryshohet ka dhënë autorizimin e tij, Kryeregjistruesi nuk do të bëjë ndryshimet e mëposhtme ndaj atij regjistrimi:

a) fshirjen e këtij barrëmarrësi nga ky regjistrim; ose

b) ndryshimin e informacionit ose transferimin e të drejtës së këtij barrëmarrësi.

Kryeregjistruesi mund të regjistrojë një njoftim pa pasur nevojë për provë që nënshkrimi në këtë njoftim është i barrëmarrësit apo i një personi të autorizuar nga barrëmarrësi.

Neni 7
Emri i barrëdhënësit dhe i barrëmarrësit

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person fizik, në njoftim duhet të vendoset emri i personit.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person juridik, në njoftim duhet të vendoset emri i personit.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person fizik që kryen veprimtri tregtare me një emër i cili nuk është emri i tij dhe kjo veprimtari tregtare nuk përbën person juridik, atëherë në njoftim duhet të shkruhet emri i personit fizik.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është ortakëri që ka një emër të regjistruar, në njoftim duhet të vendoset emri i ortakërisë. Në qoftë se ortakëria nuk ka një emër të regjistruar, atëherë në njoftim duhet të vendosen emrat e ortakëve.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është ndonjë lloj tjetër personi që nuk është përmendur në paragrafet e mësipërme të këtij neni, në njoftim duhet të vendoset emri që barrëdhënësi ose barrëmarrësi ka përdorur në marrëveshjen siguruese. Në qoftë se në çastin e regjistrimit nuk ekziston marrëveshje siguruese, në njoftim duhet të vendoset emri i përdorur zakonisht nga barrëmarrësi ose barrëdhënësi gjatë veprimtarisë tregtare.

Neni 8
Përshkrimi i kolateralit

Kur regjistrohen mallra me numër serie që nuk janë inventarë, përshkrimi duhet të përfshijë:

a) llojin e mallrave siç parashikohet në Tabelën III të Udhëzuesit të Kryeregjistruesit;

b) 25 karakteret e fundit të numrit të serisë së mallrave me numër serie;

c) emrin e prodhuesit siç është shënuar mbi mallrat; dhe

ç) vitin e prodhimit të mallrave.

Kur një regjistrim ose një ndryshim regjistrimi bëhet për:

a) kolateral që nuk është mall me numër serie; ose

b) mallra me numër serie që janë inventare

kolaterali mund të përshkruhet, kur është rasti, si “inventare”, “llogari”, “instrumente”, “para” dhe, në rastin e mallrave të tjera, përshkrimi bëhet në mënyrë të përgjithshme ose të veçantë.

Përshkrimi i mallrave si “mallra konsumi” ose si “pajisje” nuk mund të përdoret, përveç kur përshkrimi specifikon gjithashtu llojin e mallrave të konsumit apo pajisjeve. Për shembull, përshkrimi mund të jetë “pajisje bujqësore” ose “mallra konsumi, televizor”.

Përshkrimi i mallrave si “inventare” nuk është i vlefshëm kur mallrat nuk janë më inventare.

Të ardhurat koleteral duhet të përshkruhen në të njëjtën mënyrë si kolaterali fillestar i të njëjtit lloj.

Me përjashtim të mallrave me numër serie që klasifikohen si pajisje ose mallra konsumi, përshkrimi i kolateralit mund të jetë si vijon:

a) mbi të gjithë pasurinë që barrëdhënësi ka në çastin e lidhjes së marrëveshjes siguruese si dhe mbi të gjithë pasurinë e fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguruese; ose

b) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguruese, duke përjashtuar zëra të veçantë apo lloje të pasurisë; ose

c) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguruese, e cila është e një lloji të veçantë.

Neni 9
Vërtetimi

Kur regjistrohet një barrë siguruese ose pretendim shtetëror ose kur ndryshohet një regjistrim Kryeregjistruesi do t’i dërgojë barrëdhënësit, barrëmarrësit dhe personit regjistrues një vërtetim të regjistrimit me postë të zakonshme ose ndonjë mënyrë tjetër të vendosur nga Kryeregjistruesi.

Neni 10
Kërkimi i informacionit

Një person mund të kërkojë informacion nga Regjistri mbi bazën e një prej kritereve që vijojnë:

a) emri i barrëdhënësit;

b) numri i serisë së mallrave me numër serie; ose

c) numri i regjistrimit.

Informacioni që Regjistri jep në përgjigje të kësaj kërkese duhet të përfshijë të dhënat aktive të rajtura në Regjistër, që i korrespondojnë emrit të barrëdhënësit, numrit të serisë së mallrave me numër serie dhe numri të regjistrimit. Rezultati i kërkimit duhet të përmbajë, gjithashtu, datën, orën e regjistrimit dhe numrin që i është caktuar regjistrimit.

Kryeregjistruesi i dërgon personit që ka bërë kërkesën për informacion rezultatin e kërkimit me postë ose sipas ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Neni 11
Gabimet e Regjistrit

Kryeregjistruesi, me iniciativën e tij personale ose me kërkesën e barrëmarrësit, mund të korrigjojë gabimet e bëra nga Regjistri gjatë regjistrimit të të dhënave për barrën siguruese.

Korrigjimet e bëra nga vetë Kryeregjistruesi janë të vlefshme duke filluar nga çasti i bërjes së ndryshimeve dhe nuk kanë efekt prapaveprues.

Neni 12
Dorëzimi i njoftimeve dhe çështje të tjera

Njoftimet mund të dorëzohen në Regjistër personalisht, me postë ose sipas ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Regjistrimi apo kërkimi i informacionit nuk mund të bëhet në qoftë se nuk është bërë pagesa përkatëse siç parashikohet në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Kryeregjistruesi mund të bëjë marrëveshje me çdo person për mënyrën e pagesës së tarifave për shërbimet e Regjistrit. Kjo marrëveshje mund të parashikojë depozitimin e një shume që mbahet nga Regjistri nga e cila debitohen tarifat për shërbimet e Regjistrit.

Tarifat që jepen në në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit duhet të paguhen për shërbimet e Regjistrit.

Orari i punës së Regjistrit do të jetë nga ora 9.00 deri në orën 17.00 nga e hëna deri të premten duke përjashtuar ditët e festave zyrtare.

Neni 13
Mirëmbajtja e Dokumenteve të Regjistrit

Kryeregjistruesi duhet t'i mbajë njoftimet e regjistrimit, kopjet e rezultateve të kërkimit dhe kopjet e çertifikatave të Kryeregjistruesit, në formë dokumenti, kompjuterike ose në ndonjë formë tjetër për jo më pak se dhjetë vjet pas datës së përfundimit të regjistrimit, të cilit i referohet ky dokument.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Rregullorja e Barrëve Siguruese hyn në fuqi ditën e parë të fillimit të veprimtarisë së Regjistrit të Barrëve Siguruese, më datë 1 shkurt 2001.

MINISTRI I FINANCAVE
Anastas Angjeli

NDREQJE GABIMESH

Në Fletoren Nr.49 në Udhëzimin nr.5 dhe 6 datë 11.12.2000 në fund të shënohet:
Ministri i Pushtetit Lokal Bashkim Fino.

Gjithashtu në Fletoren Nr.49, në Vendimin e KM nr.726 datë 21.12.2000 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" në faqen 2119, pika 19 është:

Drejtuesit dhe specialistët e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë marrin një shtesë Ministri i Drejtësisë
bëhet:
Drejtuesit dhe specialistët e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë marrin një shtesë për natyrë të veçantë pune deri 30 për qind mbi pagën bazë, sipas përcaktimit që do të bëjë Ministri i Drejtësisë.

Kjo eshte kopje akti dhe ne perputhje me Udhezimin nr.8089,date 22.11.2006 te Ministrit te Drejtesise dhe Ministrit te financave çmimi eshte 10 leke per flete.
Çmimi i kopjes se ketij akti eshte 19 flete x 10 leke = 190 leke

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.2.2001
Doli nga shtypi më 26.2.2001

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi 150 lekë